



MALËSIA

E përdyjavshme, tribunë e mendimit intelektual të Malësisë së Madhe, viti IV i botimit, Nr.37, çmimi 30 lekë



Qeveria pregatit listat e arrestimeve si në 91



Dogana e Hanit të Hotit vetëm pikë kufitare



Demokratët në provë si 10 vite më parë

Populli punësohet në... sheshe

Zgjedhjet e pushtetit lokal në thelb të konjunkturave politike axorën të humbur atë që ishte i humbur për dekada të tëra, pra, popullin, ndërsa të fituar axorën kastën e kuqe komuniste që në të vërtetë na dhunoi për dekada të tëra, e tash haptas.

Zgjedhjet e pushtetit lokal bënë që jo vetëm qytetarët e Tiranës, por edhe katundarët dhe tërë shqiptarët mbarë, të mësojnë përmendësh rrugët e kryeqytetit. Dhe kjo meritë i takon qeverisë sonë të «ndershme». Kjo qeveri, ky shtet, bënë që tërë njerëzit të vërshojnë në shesh, në protesta kundër varfërisë, kundër errësirës, kundër vjedhjes së votës, vjedhjes së djersës. Pra protestat bënë që populli të kalojë pak orë jashtë shtëpisë që e ka bosh. Pleqtë e plakët që i ka lënë takati, u rrinë gati djemve e vajzave kur vjen orari për të dalë në protesta kundër shtetit të «ndershëm» socialist dhe po ashtu u rrinë gati kur vjen orari për të ardhur në shtëpi. Ata i pyesin si dikur kur ktheheshin nga puna, a u lodhët, si e kaluat, nesër do vemi prapë, pra a keni punë?

Ata, protestuesit, përgjigjen se do kenë punë deri sa të rrëzojnë të «ndëruarën» qeveri. E kështu, protestuesit çdo ditë bëjnë gati veglat e punës për të nesërmen: shkruajnë parulla kundër të «ndershmit» shtet, bëjnë gati shkopinjtë gjatë, mbushin shopat dhe trutat me domate, kasiravetë e vënë për të qëlluar mbi

institucionet e të «ndershmit» shtet, madje edhe vishen trashë që të durojnë sa më shumë shkopinjtë e gomës nga shteti i tyre.

Dhe këtë punë të lodhshme kundër shtetit që e «don» aq shumë, populli nuk e bën se ka në krye doc. Prof. Sali Berishën, as se ka në krye të shtetit Fatos Nanon e Ilir Metën, por e bën se kosi nuk mban më ujë, se e keqja i ka vajtur në palcë, se don t'i thotë botës nuk jemi popullskllav që durojmë poshtërim.

E, zemërimi nuk është vetëm sa sheshi «Skënderbej» por ka përmasa mbarëkombëtare. Protesuesit e përditshëm të Tiranës nuk janë vetëm, kanë shokë të gatshëm ngado. Këtë e vërteton edhe qëndrimi aktual i shtetit e qeverisë.

Përballë protestuesve janë blindat, skafandrat, grykat e topit, kallashët, shkopinjtë e gomës. Në pamje të parë duket se janë në «punë» vetëm protestuesit që hedhin ndonjë shishe andej nga godina e kryeministrit apo ministria e rendit si dhe ndonjë polic që vete i largon, por në të vërtetë në punë janë edhe kurbat e gjata të ushtarëve, policëve e spiunëve që rrinë gati e nuk ua mban prapanica ta mbushin armën me fishekë luftarakë, por mësimorë. Në punë është edhe shteti që çirret se mitingjet janë të paligjshme dhe nuk ia mban ti ndalojë. Kjo «fazë» proteste reminishon me kohën e Enverit, kur tjetër orar pune kishte populli e

Gjekë Marinaj ambasador i kulturës shqiptare në ShBA



tjetër orar pune kishte shteti komunist. Populli punonte ditë-natë, pra me tre turne, komunistët punonin në zyrë. Edhe tash shteti po punon në zyrë, pasi përballë popullit nuk mund të dalë, se «duhen» shumë. Madje zyrat e ministrive, të institucioneve shtetërore janë bosh gjithëherë kur populli del në shesh. Kjo kuptohet, komunistët nuk janë si populli. «Faza» tjetër e protestës popullore kundër shtetit të «ndershëm» mund

të jetë ndryshe. Atëherë diktatorët nuk mund të jenë sipër popullit, por poshtë tij. Në këtë pikëpamje populli të mos ankohet se nuk ka punë, por se, shqiptarët, si të vuajtur që jemi kur marrim përsipër një punë dimë të punojmë edhe me akord. Dikur kemi çarë edhe malet me bukë, groshë e dinarit.

Sokol Pepushaj

Fatos Nano shiti të «ëmën» në Greqi

Vocët e Haxhi Lleshit

Ne Kelmend do te behet rinumerimi i votave

Eshte ky vendimi i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve i ardhur ne Gjykatën e Qarkut Shkoder ditën e premtë. Pas këtij vendimi Gjykata do te krijojë një komision te posaçshëm për te bërë rinumerimin e votave ne qendren e votimit ne fshatin Vukel. Sidoqoftë, ka arsy se kjo histori perseri nuk do te mbarojë me lehtë.

Kush i vodhi ndihmat

Shkarkohet Adil Vuçaj



Botues: Isuf Gilaj adresa: Prone
godinës së Keshillit të Riçësht Kopsik, Nr. 1
Ilogaritë 631/2712 i BK Kopsik, M. e Malësie